VENDIM
Nr. 118, datë 18.3.2000

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR DHËNIEN ME KONCESION, TË FORMËS "ROO", TË UZINËS SË SUPERFOSFATIT NË LAÇ, NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT DHE SHOQËRISË "EVERTRADE, S.A."

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës , të nenit 3, pika 6,dhe neneve 4 dhe 9, pika 3, të ligjit nr .7973, datë 26.7.1995, "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e kontratës për dhënien me koncesion, të firmës "ROO", për rehabilitimin e Uzinës së Superfosfatit, Laç, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë "Evertrade", S.a .

2. Paragrafi i katërt, në nenin 6 të kontratës së koncesionit është i vlefshëm pas miratimit të ligjit përkatës nga Kuvendi.

3. Punonjësit, që do të ndërpresin punën me fillimin e kësaj kontrate dhe nuk zhvillojnë veprimtari, në formën e punësimit apo të vetëpunësimit, do të trajtohen financiarisht me pagën minimale, për një periudhë njëvjeçare. Fondi për këtë qëllim do të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, për vitin 2000. Periudha njëvjeçare, për punonjësit që do të trajtohen sipas këtij vendimi, njihet si vjetërsi pune për efekt pensioni dhe shënohet si e tillë në librezën e punës.

4. Ngarkohet Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e pikës 3 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta